

ora 15:40

ANKESË

11.3.
Datë / /2023

- ANKUES:** Partia “Lëvizja Bashkë”, përfaqësuar nga z. Arlind Qori;
- DREJTUAR:** Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve
- OBJEKTI:** 1. Kundërshtimin e vendimit nr. 157, date 09.03.2023, ora 10:00 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Mosregjistrimin si subjekt zgjedhor të partisë politike “Lëvizja Bashkë” me kryetar z. Arlind Qori, me shkronjat nistore “Bashkë”, në zgjedhjet për organet vendore të datës 14 maj 2023.
- BAZA LIGJORE:** Nenet 21, pika 1, shkronja “b”; 64; 124/1; të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, neni 9 e vijues i ligjit Nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. AKT-THEMELIMI DHE PROCESI I MBLEDHJES SË NËNSHKRIMEVE PËR REGJISTRIMIN NË GJYKATË

Më 18/12/2022 – është mbajtur mbledhja me anëtarët themelues/nismëtarë të cilët vendosën: Miratimi në tërësi i programit të partisë politike Lëvizja BASHKË; Miratimi i Statutit nen për nen dhe në tërësi; Kryetarin e partisë, si dhe u autorizua Kryetari i partisë politike Lëvizja BASHKË të nënshkruajë në emër të tyre dhe të paraqesë në Gjykatë kërkesën për regjistrimin si person juridik dhe të ndjekë të gjitha procedurat e regjistrimit, duke pasur të drejtën e delegimit të këtyre të drejtave te një person i tretë me prokurë të posaçme.

Nga data 18/12/2022 deri në datën 08/01/2023 është zhvilluar procesi i mbledhjes së mbi 3500 nënshkrimeve të anëtarëve themelues për regjistrimin e partisë politike Lëvizja BASHKË, ku i gjithë procesi ka qenë konform nenit 10 të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike” dhe kuadrit ligjor në përgjithësi.

2. SITUATA ME GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

Më 09/01/2023 – është protokolluar kërkesa për regjistrim së bashku me të gjitha dokumentacionet e parashikuara në ligjin Nr.8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, si:

Procesverbali i mbledhjes së grupit nismëtar themelues i noterizuar; Statuti i Partisë i noterizuar; Programi i partisë i noterizuar; Nënshkrimet e anëtarëve themelues.

Më 19/01/2023 i kemi dërguar shkresë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe Kancelarit të Gjykatës z. Donald Xhelili që të shqyrtojë kërkesën e regjistrimit të partisë politike Lëvizja BASHKË duke respektuar afatet ligjore të përcaktuar në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar.

Më 27/01/2023 i kemi dërguar shkresë Gjyqtarit të çështjes, z. Agron Zhukri të shqyrtojë kërkesën e regjistrimit të partisë politike Lëvizja BASHKË duke respektuar afatet kohore të përcaktuara në ligjin Nr.8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar.

Më 20/02/2023 – Njoftohemi që seanca për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike Lëvizja Bashkë është përcaktuar data 07/03/2023

Më 21/02/2023 i kemi dërguar shkresë z. Agron Zhukri që të tërheqë datën e seancës sepse na pamundësonte regjistrimin e Lëvizjes BASHKË në zgjedhjet e 14 Majit 2023, si dhe ky rast ishte në shkelje me nenin 9 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, sipas të cilit “Partitë politike krijohen lirisht. Organizimi i tyre duhet të përputhet me parimet demokratike.” Gjithashtu ky rast është në shkelje të nenit 13 të ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”.

Më 21/02/2023 nëpërmjet shkresave kemi informuar Z. Ilirjan Celibashi, Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, z. Flamur Kapllani, Zv.Kryetarin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, z. Artur Metani, Inspektoriatit i Lartë i Drejtësisë, për shkeljen e afateve ligjore për regjistrimin e partisë Lëvizja BASHKË, gjë që do pamundësonte pjesëmarrjen e partisë Lëvizja Bashkë në zgjedhjet vendore të datës 14/05/2023.

Nëpërmjet postës elektrike kemi njoftuar për këtë situatë OSBE-në, Ambasadën Gjermane, Ambasadën Zvicerane, Ambasadën Amerikane, Ambasadën Suedeze, Delegacionit të Bashkimit Evropian në Shqipëri

Më 27/02/2023 Inspektorati i Lartë i Drejtësisë na dërgon shkresë që ankesa jonë është regjistruar me nr 609, në të cilën thuhej që do vepronin ndaj çështjes dhe për çdo vendim që do merrnin ndaj gjyqtarit Zhukri do të na njoftonin.

Më 02/03/2023 njoftohemi që ishte ndryshuar gjyqtari që do të shqyrtonte kërkesën tonë për regjistrimin e partisë dhe po atë ditë do të zhvillohej seanca me gjykatës Z. Arben Konstandini. Z. Kostandini pasi shqyrtoi kërkesën e pranoi kërkesën e Lëvizjes BASHKË për tu regjistruar në regjistrin e partive politike.

Më 03/03/2023 kemi tërhequr dispozitivin dhe vërtetimin për regjistrimin e kërkesës shkurtim-vendimi

3. SITUATA ME KOMISIONIN QENDROR ZGJEDHOR

Më 06/03/2023 referuar nenit 64 dhe 92/2 të të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, dhe Udhëzimit nr.1, datë 18.01.2023 të miratuar nga

KQZ, kemi depozituar kërkesën dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim të Lëvizjes BASHKË pranë KQZ-së; Konkretisht: Kërkesën për regjistrim e cila përmban Emrin, mbiemrin dhe adresën e kryetarit të partisë, i cili është i autorizuar për të paraqitur kandidatët; Emrin Zyrtar, shkronjat nistore dhe adresën e partisë; Specimenin e vulës; Emrin, Mbiemrin dhe adresën e financierit; Shkurtime dhe Vendimit e marrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; Deklarata e angazhimit solemn të kryetarit të partisë politike Model KQZ-04-02; Deklaratë për hapje llogarie të posaçme bankare të partisë politike Model KQY-04 -03.

Më 09/03/2023 ora 10:00 Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet pasi shqyrtoi kërkesën e partisë politike “Lëvizja Bashkë” për regjistrimin si subjekt zgjedhor për organet vendore të datës 14 maj 2023 vendosi: Mosregjistrimin si subjekt zgjedhor të partisë politike “Lëvizja Bashkë” me kryetar z. Arlind Qori, me shkronjat nistore “Bashkë”, në zgjedhjet për organet vendore të datës 14 maj 2023.

Argumentimi ligjor:

Neni 13 i ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar përcakton se:

“Regjistrimi i partisë politike bëhet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës për regjistrim dhe të dokumenteve të parashikuara në nenin 10 dhe 11 të këtij ligji”.

Siç mund të provohet kërkesa është depozituar më 09/01/2023 pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë për regjistrimin e partisë politike Lëvizja Bashkë. Por në mënyrë të qëllimshme gjyqtari Agron Zhukri ka shkelur haptazi dhe pa arsye ligjin. Themi në mënyrë të qëllimshme pasi këtë gjë e tregon caktimi i seancës për shqyrtimin e kërkesës më datë 07/03/2023, një ditë pas përfundimit të afatit ligjor për dorëzimin e dokumentacionit për regjistrimin si subjekt zgjedhor për organet vendore të datës 14 maj 2023 pranë KQZ-së. Në këtë mënyrë ai dëshiroi mohimin e vullnetit politik të 3500 qytetarëve.

Me ndërhyrjen e ILD-së u arrit që më 02.03.2023 të zhvillohesh seanca për regjistrimin e partisë me një gjyqtar tjetër ku u vendos: *-Pranimi kërkesës, -Regjistrimin si person juridik të partisë “Lëvizja Bashkë”, në Regjistrin e Partive Politike pranë Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Referuar nenit 64 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, kemi dorëzuar dokumentacionin për regjistrimin e i partisë politike “Lëvizja Bashkë” si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Me vendimi Nr. 157, datë 09.03.2023, ora 10:00 Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet ka vendosur - *Mosregjistrimin si subjekt zgjedhor partisë politike “Lëvizja Bashkë”, me kryetar z. Arlind Qori, me shkronjat nistore “BASHKË”, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.*

Sipas interpretimit të Komisionerit, Partia “Lëvizja Bashkë” nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e 14 maj 2023.

Argumenti kryesor i tij është se ky vendimi Nr.2, datë 02/03/2023 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk është i formës së prerë e si rrjedhojë nuk është i pasqyruar në regjistrin e partive politike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për sa i përket këtij argumentimi ne do të parashtrojmë kundërshtimet tona si më poshtë:

Së pari, neni 9 i ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar përcakton se: *Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë.*

Në vendimi Nr. 2, datë 02/03/2023 është miratuar njohja e partisë politike “Lëvizja Bashkë” si person juridik, si dhe është urdhëruar regjistrimi saj në Regjistrin e Partive Politike. Kjo tregon se nga ana formale është përmbushur detyrimi ligjor për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e 14 maj 2023. Data kur gjykata ka miratuar njohjen e partisë politike “Lëvizja Bashkë” si person juridik është data 02/03/2023, që përmbush nga ana formale kriterin e përcaktuar në germën “a” të pikës së dytë të nenit 64, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.

Për sa i përket përmbajtjes së dispozitivit ku gjykata shprehet se - *ndaj këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit, afat ky që fillon nga e nesërmja e shpalljes së tij.* Kjo është një e drejtë procedurale që bazohet në nenin 15 të ligjit nr. 8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, por që ligji nuk përcakton se cilët janë subjektet që mund ta ankimojnë këtë vendim. Në mungesë të këtij përcaktimi ligjor, vendimi nr.2, datë 02/03/2023 mund të themi se në mënyrë indirekte është vendim i formës së prerë.

Së dyti, referuar praktikës së Komisionit Qendror Zgjedhor me vendimin nr. 230, datë 27/04/2019, ora 10:00, ku është vendosur: - *“Regjistrimi i partisë “Bindja Demokratike”, me kryetar z. Astrit Patozi, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019”, në mënyrë kolegjiale është pranuar shqyrtimi për regjistrimin e kësaj partie vetëm me kërkesën për regjistrim drejtuar Gjykatës, dhe në seancën publike të Komisionit Qendror Zgjedhor partia politike ka dorëzuar Vërtetim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë të njëjtë më atë të dorëzuar nga ana jonë. Ky dokument është pranuar nga ana e institucionit të KQZ-së gjatë seancës publike për shqyrtimin e kërkesës së partisë politike për t’u regjistruar si subjekt zgjedhor, si konform kriterit të përcaktuar në germën “a”, të pikës 2 të nenit 64 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.*

Madje, në rastin e vendimi nr.8, datë 25/04/2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, 4 qytetarë emrat e të cilëve kanë qenë pjesë i listës së nënshkrimeve të dorëzuar në Gjykatë, kanë bërë deklaratë publike për falsifikim të nënshkrimeve të tyre. Ky fakt nuk është marrë parasysh në vendimmarrjen e Komisionit Qendror Zgjedhor.

Ndërsa, për sa i përket vendimit nr.2, datë 02/03/2023 për regjistrimin e partisë politike “Lëvizja Bashkë” deri më tani nuk ka pasur asnjë reagim publik të asnjë nga 3500 nënshkruesit.

Së treti, mosregjistrimi i Lëvizjes Bashkë në zgjedhjet e 14 majit do të ishte një goditje e rëndë ndaj të drejtës së qytetarëve për t’u organizuar në parti dhe për të konkurruar në zgjedhje, si

dhe i pluralizmit politik në tërësi, çka do të përbënte një precedent të rrezikshëm për ardhmërinë e demokracisë në Shqipëri.

Për sa më sipër mbështetur në nenet 21, pika 1 shkronja 'b', të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", kërkojmë:

1. Shqyrtimin e kësaj ankese administrative ndaj Vendimit nr. 157, datë 9.3.2023 të Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve;
2. Zgjidhjen e kësaj ankese duke vendosur regjistrimin e partisë politike "Lëvizja Bashkë" si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e organeve për qeverisjen vendore të datës 14 maj 2023;

Me respekt!

Arlind Qori



